Sektori i Ndihmës ekonomike & PAK

Lloji i dokumentit të ofruar	Afati i marrjes	Pagesa
Vërtetim trajtimi me ndihmë ekonomike	1 ditë	Falas
Vërtetim për mospërfitim të ndihmës ekonomike	1 ditë	Falas
Vërtetim trajtimi dhe pagese për personat me aftësi të kufizuara	1 ditë	Falas
Vërtetim për trajtimin me pagesë si invalid pune (shtesa që merret në Bashki)	1 ditë	Falas
Vërtetim trajtimi dhe pagese për personat paraplegjik ose tretraplegjik	1 ditë	Falas
Vërtetim trajtimi dhe pagese për të verbër	1 ditë	Falas
Vërtetim si kujdestar/e për persona me aftësi të kufizuara, të verbër , parapleegjik dhe tetraplegjik.	1 ditë	Falas

Sektori i ndihmesekonomike

Në kuadër të informimit:

Baza ligjore: Ligji nr. 57/2019 " Për asistencën në Republikën e Shqipërisë*", VKM* **Nr.597, datë 4.9.2010 "** Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike":

PERFITIMI I NDIHMES EKONOMIKE

Përfituesit e ndihmës ekonomike janë:

a) familjet në nevojë, që nuk kanë të ardhura ose kanë të ardhura të pamjaftueshme;

b) jetimët, të cilët nuk janë në institucionet e përkujdesjesshoqërore;

c) prindërit me më shumë se 2 fëmijë të lindur njëherësh, që u përkasin familjeve në nevojë;

ç) viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesjes shoqërore, deri në çastin e punësimit të tyre;

d) viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrit të mbrojtjes ose të urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, që nuk trajtohen në institucionet e përkujdesjesshoqërore.

dh) fëmijët pa kujdes prindëror të vendosura në familje kujdestare me vendim të formës së prerë të gykatës.

Aplikimi për të përfituar ndihmë ekonomike bëhet pranë zyrave të Ndihmës Ekonomike nga data 01-10 të çdo muaji.

Të gjithë përfituesit e ndihmës ekonomike duhet të paraqiten çdo tre muaj nga data 01-10, për të deklaruar ndryshimet e situatës social-ekonomike. Në rast të kundërt refuzohen nga sistemi elektronik për një periudhe 6-mujore.

DOKUMENTAT:

- Certifikatë familjare (shërbimi ofrohet pranë zyrës së ndihmës ekonomike përmes portalit e-Albania)
- Kopjen e kartës së identitetit të aplikantëve (bashkëshortëve dhe anëtarëve mbi 18vjeç)
- Certifikatën e pronësisë, të lëshuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës /vërtetimin e lëshuar nga Zyra e Kadastrës, apo aktin e marrjes në pronësi ose në përdorim të tokës, për zonat ku regjistrimi i pronësisë nuk ka përfunduar ende.
- Vërtetimin për fëmijët , për ndjekjen e shkollës të lëshuar nga vetë shkolla, i cili është i detyrueshëm për t'u dorëzuar dy herë brenda një viti shkollor, për të përfituar pagesën shtesë.
- Fotokopje nga libri i shëndetit të fëmijës për vaksinën e kryer, sipas kalendarit të detyrueshëm për grupmoshat e fëmijëve, për të përfituar pagesën shtesë.
- Për anëtarët madhorë në familje në moshë aktive për punë por që ndjekin studimet e larta, vërtetimin e lëshuar nga institucioni arsimor, i cili është i detyrueshëm për t'u dorëzuar një herë brenda një vitishkollor.
- Jetimët, të cilët nuk janë në institucione të përkujdesjes shoqërore, kopjen e noterizuar për statusin e jetimit, sipas kërkesave të parashikuara në ligjin për statusin e jetimit, tëndryshuar.
- Viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesjes shoqërore deri në çastin e punësimit të tyre, paraqesin vërtetimin e trajtimit në institucionet e përkujdesjes shoqërore, të lëshuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve të fundit.
- Viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare,për periudhë ne vlefshmërisë së urdhrit të mbrojtjes ose të urdhërit të menjëhershëm të mbrojtjes, paraqesin urdhrin e mbrojtjes të lëshuar nga gjykata.
- Vërtetim i vuajtjes së dënimit për personat e ndaluar.
- Familjet përfituese të ndihmës ekonomike duhet të sjellin pranë zyrave tona librezën e energjisë elektrike me pagesën e muajit paraardhës.

PERFITIMI I NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI SHTESË MBI FONDIN E KUSHTËZUAR PËR NDIHMËN EKONOMIKE

Kriteret e miratuara me Vendim të Këshillit Bashkiak

1. Familjet në nevojë do të përzgjidhen nga lista e familjeve që kanë aplikuar brenda **tre muajve të fundit** nepërmjet regjistrit elektronik për ndihmën ekonomike dhe që nuk janë shpallur përfitues nga sistemi i pikëzimit.
2. Dokumentacioni dhe masa e përfitimit llogaritet sipas strukturës së familjes mbështetur në Udhëzimin nr. 4 dt. 17. 02. 2017 " Për përllogaritjen e përfitimit të NdihmësEkonomike".

3. Familje pa të ardhura
4. Familje me kryefamiljare femra në vështirësi ekonomike dhe sociale
5. Familjet me persona me aftësi të kufizuar dhe që nuk përfitojnë KMCAP
6. Familjet të cilat kanë në përbërje një ose më shumë anëtar me paaftësi/ invalidë
7. Kryefamiljaret, femra të divorcuara
8. Persona të vetëm mbi moshë punë

Sektori i Personave me Aftesi te Kufizuar(PAK)

VKM Nr. 618, datë 7.9.2006 "Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar"

➢ Dokumentat e përfitimit për personat me aftësi të kufizuara :

- Fletë drejtim KMCAP (Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë përPunë)
- Fletë- dalje nga spitali
- Referim (rekomandimi i mjekut të familjes)
- Certifikatë familjare (për personat mbi 16 vjeç) dhe personale me foto për personat nën 16vjeç
- Ekzaminime sipas diagnozes (eko,grafi,skaner,anilza, EKG etj.)
- Vërtetim nga Sigurimet Shoqërore për vitet e punës.
- Fotografi dokumenti
- Fotokopje e kartës së identitetit

(Këto dokumenta vlejnë edhe për rikomisionim të dosjeve duke zëvendësuar fletë drejtimin e KMCAP-it me Epikrizë Përcjellëse.)

➢ Perfitimet:

- Kompensimi i energjisë elektrike në rastin kur kryefamiljari është me aftësi të kufizuara sipas legjislacionit në fuqi. Libreza e energjisë elektrike duhet të jetë në emër të kryefamiljarit.
- Kjo kategori merr pagesë në masën 200% gjatë ndjekjes së shkollës së mesme dhe 300% gjatë ndjekjes së studimeve të larta ku duhet të paraqesin çdo tre muaj një vërtetim mbi ecurinë e ndjekjes së shkollës.
- Në ndjekje studimeve të larta në Universitet, personat me aftësi të kufizuara përjashtohen nga tarifa e shkollës.

LIGJI Nr.8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e te verbërit”

➢ Dokumentat per Statusin e të Verbërit:

- Fletë drejtim nga KMPV (Komisioni Mjekësor për përcaktimin e Verbërisë)
- Fletë - dalje nga spitali
- Referim (rekomandimi i mjekut te familjes)
- Certifikatë familjare (për personat mbi 16 vjeç) dhe personale me foto për personat nën 16vjeç.
- Ekzaminime
- Fotografi
- Fotokopje e kartës sëidentitetit
- Kërkesë me shkrim

(Këto dokumenta vlejnë edhe për rikomisionim të dosjeve duke zëvendësuar fletë drejtimin e KMCAP-it me Epikrizë Përcjellëse.)

➢ Perfitimet:

- Kompensim i energjisë elektrike duke paraqitur librezën e energjisë elektrike çdo muaj.
- Kompensim i tarifes se telefonise fikse duke paraqitur kontratën përkatëse dhe librezën me pagesën mujore.
- Kjo kategori merr pagesë në masën 200% gjatë ndjekjes së shkollës së mesme dhe 300% gjatë ndjekjes së studimeve të larta ku duhet të paraqesin çdo tre muaj një vërtetim mbi ecurinë e ndjekjes së shkollës.
- Në ndjekje studimeve të larta në Universitet, personat e verbër përjashtohen nga tarifa e shkollës.

L I G J Nr.8626, datë 22.6.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”

- Dokumentat per Statusin e Para-Tetraplegjisë

- Fletë drejtim KMCAP (Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë)
- Fletë dalje nga spitali
- Referim (rekomandimi i mjekut telagjes)
- Certifikatë familjare (për personat mbi 16 vjeç) dhe personale me foto për personat nën 16vjeç.
- Ekzaminime (eko,grafi,skaner,anilza.EKG,cdetj.).
- Fotografi.
- Fotokopje e kartës sëidentitetit.
- Kërkesë me shkrim

(Këto dokumenta vlejnë edhe për rikomisionim të dosjeve duke zëvendësuar fletë drejtimin e KMCAP-it me Epikrizë Përcjellëse.)

Perfitimet:

- Kompensim i energjisë elektrike duke paraqitur librezën e energjisë elektrike çdo muaj
- Kompensim i tarifes se telefonise fikse duke paraqitur kontratën përkatëse dhe librezën me pagesën mujore.
- Kjo kategori merr pagesë në masën 200% gjatë ndjekjes së shkollës së mesme dhe 300% gjatë ndjekjes së studimeve të larta ku duhet të paraqesin çdo tre muaj një vërtetim mbi ecurinë e ndjekjes së shkollës.
- Në ndjekje studimeve të larta në Universitet, personat e paraplegjik përjashtohen nga tarifa e shkollës.

- **Dokumentat e kujdestarit (ndihmësit personal) për të gjitha kategoritë:**

- Raport mjeko-ligjor.
- Deklaratë noteriale.
- Fotokopje karteidentiteti
- Certifikatë familjare